



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Punëtim/Prodato Received/Delivered	11.08	2023	3	viti god year
Organ Njësia Org/Unit	KRMSTICK	5623/2023	Shtojcë / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
				1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.987/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën sipas ankesës A.nr.987/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesja, me adresë në Pejë, kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.987/2023 të datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile [Blank] e punësuar në Komunën e Pejës në pozitë të "Zyrtar i Zyrës Komonale për Gjendjen Civile", më datë 08.06.2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Zyrës së Personelit të Komunës së Pejës lidhur me kategorizimin e pozitës në Profesionale 3. Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Pejës më datë 13.06.2023 përmes përgjigjes në ankesë njofton ankuesen se nuk është kompetencë e komunës rregullimi i koeficienteve por kjo është kompetencë e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ankuesja kundër kësaj përgjigjeje më datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.991/2023, me pretendimin ankimor së kategorizimi i pozitës së ankueses në klasën "Profesional 3" është bërë në shkelje të dispozitave materiale dhe në vlerësimin e ankueses pozita e saj duhet të klasifikohet në "Profesional 2".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës, ndërsa me datë 26.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 05.02.2016, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës 'Zyrtare e Zyrës Komunale për Gjendjen Civile' në Komunën e Pejës dhe ka realizuar koeficientin e pagës pesë (5).

Ankuesja, me datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,me pretendimin ankimor se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik më datë 05.02.2023, e njëjta është kategorizuar në nivelin profesional 3, përkundër që sipas pretendimit të ankueses duhet të jetë profesional 2.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizim i shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pejës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të



Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim merititor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme edhe në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në at që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.987/2023, datë 11/08/2023.

**Vjollca SINANI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesja, .....
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

